



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 5

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 26.02.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Shkurt 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.”
4. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit “Subvencionim i interesave të kredisë.”
5. **Projekt-Vendim** “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullor për sipërfaqe ndihmese në funksion të sheshit të depozitimit dhe magazinimit të materialeve të nxjerra nga leja minerare nr 1822 date 28.10.2016”.
6. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e numrit të punonjësve sezonalë në sektorin e ujitjes dhe kullimit për periudhën prill, maj, qershor të vitit 2026 “
7. **Projekt-Vendim** “Për miratimin e taveve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029 të Bashkisë Kolonjë.”
8. **Projekt-Vendim** “Për rikualifikimin dhe kthimin në hapësira muzeale të vendstrehimeve ekzistuese në qytetin e Ersekës.”
9. **Projekt-Vendim** “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr 152 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”
10. **Kërkesë**

Protokolli i mbajtur sot më datë 17.03.2026 në mbledhjen e radhës sipas njoftimit të dhënë në datën 12.03.2026.

Të pranishëm: E.Isai, B.Jashari, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, I.Milo, T.Çaçani, A.Zeneli, S.Kodra, E.Çikopana.

Mungon: E. Xhelili A.Tartari, H.Iljazi, E.Avdi, S.Larti, I.Hodo.

Z.Meto: Përshëndetje, mirë se vini në mbledhjen e radhës. Në mungesë të kryetarit të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, në cilësinë e zëvendëskryetarit, më lind e drejta të drejtoj zhvillimin e mbledhjes së radhës së Këshillit të Bashkisë Kolonjë. Forumi është i plotë, ndaj vazhdojmë me mbledhjen e radhës sipas rendit të ditës.

Z.Meto: Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto: Ka dikush konfliktë interesi?

Z.Meto: Nuk ka konflikt interesi.

Z.Meto: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 26.02.2026 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.

Z.Meto: Jeni dakord me pikën e dytë të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto: Vazhdojmë me pikën e tre të rendit të ditës: “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Shkurt 2026, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%.”

G.Tafili: Lista emërore ka dal nga sisemi dhe ne jemi dakort.

Z.Meto: Jeni dakord me pikën e tre të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto: Vazhdojmë me pikën e katër të rendit të ditës: Për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit “Subvencionim i interesave të kredisë.

Z.Meto: Jeni dakord me pikën e katër të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto: Vazhdojmë me pikën e pesë të rendit të ditës: “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullor për sipërfaqe ndihmese ne funksion te sheshit te depozitimit dhe magazinimit te materialeve te nxjera nga leja minerare nr 1822 date 28.10.2016.

Z.Meto: Në projekt-vendim citohet që sipërfaqia ka marr një numër të ri, a ndryshohet numri i parcelës?

E.Çuka: (Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Numri i parcelës pyjore ndryshohet nga ana jonë, ndërsa numri kadastral nuk mund të ndryshohet nga ana jonë.

G.Tafili: Për cilën zonë bëhet fjalë dhe a ka dëgjesa publike?

E.Çuka: (Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Parcela ndodhet tek Rruga e Vodicsës dhe nuk është parcelë për dhënie në përdorim. Ajo është parashikuar për shtesë magazinimi materialesh. Nëse zotëria do të prodhojë më shumë material, kjo parcelë do të konsiderohen si pjesë e zonës së gurorës.

Z.Meto: Nëse objekti ka prodhim të tepërt, pjesën e tij do ta depozitojë në këtë tokë. Ligjërisht, ju duhet ta zhvilloni dëgjuesën publike dhe ta paraqisni tek ne. Ti nuk e ke investuar këtë pjesë dhe nuk e ke pasur të investuar më parë. Jemi dakort të jepet me qera por gjithmon të shoqëruar me dëgjes publike.

E.Çuka: (Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Parcela ndodhet shumë larg fshatrave dhe nuk ka ku të zhvillohet dëgjesa publike, në atë zonë nuk ka investim.

G.Tafili: Kërkohet të parashitet një listë ku të specifikohet sipërfaqet qe ndodhen në teritorin e Bashkisë Kolonjë janë të ndara tokë pyjore, tokë kullot apo tokë bujqësore. Gjithashtu, një metër tokë duhet të jepet për përdorim duhet dëgjesa publike.

E.Çuka: (Specialist Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekracionit): Ka parcela që ndodhen shumë larg dhe nuk pengojnë askënd. Aty nuk ka dëgjes publike sepse nuk di në cilin fshat duhet zhvilluar për arsye se ndodhet shumë larg. Pjesa do të përdoret vetëm për një kohë të shkurtër.

Z.Meto: Jeni dakord me pikën e pesë të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto: Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: “Për miratimin e numrit të punonjësve sezonalë në sektorin e ujitjes dhe kullimit për periudhën prill, maj, qershor të vitit 2026 “

Z.Meto: Kanali i Gostivishit a mund të filloj pastrimi para fillimit të vaditjes? Praktikisht, gjithmonë fillon të bëhet përpara se të fillojë vaditja dhe më duket shumë vonë.

G.Eminaj(Drejtor i Buqësisë dhe Zhvillimit Rural): Disa fshatra kanë shumë prurje, ne nuk mund të pastrojmë dy here në vitë sfrateve sepse janë kanale me gjatësi mbi 500 km dhe puntorët që ne kemi nuk e përballojnë këtë punë. Gjatë ketyre muajve kërkojmë puntor të tjerë për të përballuar këtë punë.

Z.Meto: Këta katër puntorë kanë shumë pak ditë pune për pastrimin e këtij kanali.

G.Eminaj(Drejtor i Buqësisë dhe Zhvillimit Rural): Ka fshatra si Qafzezi apo Borova që pastrohen shumë lehtë por fshatrat e tjerë kanë vështirësi.

Z.Meto:Jeni dakord me pikën e gjashtë të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto:Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës “Për miratimin e tavaneve buxhetore të programir buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029 të Bashkisë Kolonjë.”

G.Duka (Drjtoresh Finance): PBA 2027 -2029 për vitin 2027,2028 nuk ka ndryshime , në vitin 2029 ka ndryshime për shkak të indeksimit të pages.

Z.Meto: Në PAB keni bërë parashikime për ndarjen sektoriake e pakushtëzua.

G.Duka (Drjtoresh Finance): Udhezimi na vjen i specifikuar.

Z.Meto:Jeni dakord me pikën e shtatë të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto:Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës “Për rikualifikimin dhe kthimin në hapësira muzeale të vendstrehimeve ekzistuese në qytetin e Ersekës.”

G.Tafili: Si fillim duhet rikonstruksioni i ujrave të zeza për gjithë qytetin e Ersekës.

E.Isai: Jemi duke miratuar projektin për rikonstruksionin e ujrave të zeza me pas do filloj pastrami i pikave të vendstrehimeve ekzistuese.

Z.Meto:Jeni dakord me pikën e tetë të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto:Kemi një projekt-vendim që na ka ardhur jashtë radhe është rast emergjent “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr 152 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”

B.Ali(Drejtoresh Shërbimi Publik): Në është paraqitur një kërkesë , raportohet se në fshatin Mësicëk, banesa e zonjës rrezikohet nga ndërtesa ngjitur. Panelet lidhëse janë shkëputur, dhe ekziston rreziku që nëse bie paneli tjetër lidhës, ai mund të përplaset mbi banesën dhe të shkaktojë dëme brenda saj.

Z.Meto: Nëse ndodh një rast i ngjashëm në fshatin tjetër, banorët do të ndihmohen?

B.Ali(Drejtoresh Shërbimi Publik): Ndërtesa që rrezikon të bjerë është pronë e shtetit. Ne do të ndërhyjmë vetëm tek ndërtesat shtetërore, jo tek ndërtesat private.

Z.Meto:Jeni dakord me pikën e nëntë të rendit të ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Z.Meto: Kemi një kërkesë për një banorë në qytetin e Leskovikut, I cili ndodhet në kushte të vështira, dhe kërkohet rikonstruksioni i banesës dhe i çatisë.

G.Tafili: Kërkesa të drejtohet te Drejtoria e Shërbimit Socila dhe zoteria të marr një përgjigje.

Proces-Verbali i datë 17.03.2026 është firmosur nga 9 anëtarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT
INSUIDA ORHANAS



ZV/KRYETAR I KËSHILLIT
ZAMIRA METO

KRYETAR I KËSHILLIT
ERALDO XHELILI

